

AKT THMELIMI

I

SHOQERISE TREGTARE “SURVEY SOLUTION” sh.p.k.

Mbeshtetur ne Kushtetuten dhe Kodin Civil ne Fuqi te Republikes se Shqiperise , ne ligjin Nr.7512 date 10.08.1991 “Per sanksionimin dhe mbrojtjen e prones private, nismes se lire dhe te veprimtarise private dhe privatizimit” , te ligjit Nr. 9901 date 14.04.2008, “Per shoqerite tregtare” dhe te ligjit Nr.9723, date 03.05.2007 “Per Q.K.R dhe formalitetet qe duhen respektuar nga Shoqerite Tregtare , me vullnetin e tij te lire, te shprehur edhe ne nenshkrimin e ketij akt-themelimi ne ortaket:

1. Gerard Lleshi individ me pergjegjesi te kufizuar, datelindjes 25.11.1987, lindur ne Lac dhe banues ne Tirane, krijon shoqerine tregtare me pergjegjesi te kufizuar “SURVEY SOLUTION” sh.p.k me akt themelimi si vijon:

Formulimi

Neni 1

Formohet shoqeria tregtare private e quajtur SURVEY SOLUTION sh.p.k. Shoqeria do ti nenshtrohet legjislacionit Shqiptar, ndersa deget qe mund te krijohen do ti nenshtrohen legjislacionit ku do te kete seline dega. Shoqeria do te ushtroje veprimtarine e saj ne baze te ketij akti themelues dhe statutit te shoqerise qe do te miratohet nga ortakut themelues.

Selia e Shoqerise

Neni 2

Selia e shoqerise tregtare private “SURVEY SOLUTION” sh.p.k do te kete seline ne Muzaket, Nd. 1, H.1, Njesia Administrative Nr. 9, Njesia Administrative Nr.9, 1016, Tirane, Shqiperi.

Shoqeria mund te ndryshoje seline e saj, te hape zyra perfaqesie, dege, te krijojte filiale si brenda ashtu dhe jashte Republikes se Shqiperise, vetem me vendim te asamblese dhe ortakut te vetem.

Objektivi i Veprimtarise

Neni 3

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne fushat e:

1. Ne fushen e sherbimeve shoqeria do te realizoj: Konsulence teknike ne fusha te ndryshme, supervizion, menaxhimet dhe studimet e te gjitha llojeve, realizimi i kontratave, marreveshjeve, ortakerive, shoqerive te perbashketa apo forma te tjera, veprimtari komisionere, servis per tipet e ndryshme te automjeteve, perfaqesim, si dhe veprime te tjera te porositura nga te tretet te

lejuara nga legjislacioni shqiptar; riparimin dhe remontet e mesme dhe kapitale te makinave elektrike te cdo tipi fuqie e tensioni, te motorrave dhe transformatoreve elektrike, transformatoreve te tensionit te larte, furrave elektrike, reaktoreve te cdo tipi si dhe te gjitha paisjeve elektrike; konsulence, revizion, ekspertize, vleresime te kapitaleve dhe gjendjes, planbizneseve, projekte zhvillimi dhe studime te efektiviteteve ekonomike, percaktimi i prioriteteve ne fusha te ndryshme te ekonomise etj. Administrim fondesh dhe/ose investimesh; Sherbime ne fushen e pasurive te luajteshme dhe te paluajteshme, duke perfshire pa u kufizuar qiradhenie, administrim, menaxhim, mirembajtje, riparim, ndermjetesim etj., per vete shoqerine apo te Tretet, ne territorin e Republikes se Shqiperise apo jashte saj.

2. Ne fushen e sherbimeve inxhinierike gjeodezike do te kryej: Vleresim i pasurive te paluajteshme, akte ekspertimi per ceshtje gjyqesore, hartografi dixhital, veprimtari ne fushen e sistemeve te informacionit gjeografik (GIS), hartim software GIS, import-eksport te hartave dixhitale, kurse kualifikimi ne fushen e GIS-it. Konsulence GIS-i, piketim, rilevim me GPS. Rilevime me total station, rilevime me dron, rilevime fotogrametrike, ekspertize topografike, plane rilevimi. Vektorizime hartash, projektim rruges, kanalesh, llogaritje volumesh, punime topografike ne zbatim pallatesh, vila, rruge, hidrocentrale. Monitorime gjeodezike te veprave civile.

3. Ne fushen e ndertimit shoqeria do te realizoj: Studimin, projektimin, sipermartijen zbatuese dhe/ose investimin, per realizimin me fonde publike dhe/ose jopublike te veprave publike dhe/ose private si: ndertimin e ndertesave publike dhe private, rrugeve, urave, tuneleve, mbikalimeve e nenkalimeve, autostradave, traseve hekurudhore, dhe te gjitha veprave te tjera madhore, ujesjellesave, linjave mbitokesore dhe nentokesore per energjiine dhe telekomunikacionet, ndertimin dhe rehabilitimin e veprave ujitesore, centralet, objektet turistike, objektet ushtarake, objektet e kultit, rrjetet inxhinierike, portet, aeroportet, objektet industriale, te gjitha restaurimet ne pergjithesi, rikonstruksione te veprave te artit, montimet e konstruksioneve metalike;

4. Ne fushen e tregetise shoqeria do te realizoj: Tregtimin dhe import-eksportin me shumice e pakice, te te gjitha mallrave me ose pa akcize, duke perfshire por pa u kufizuar ne, industriale, ushqimore, mjekesore, bujqesore, blegtorale, elektroshtepiake, te ndertimit (hidrosanitare, elektrike, mobileri), te mjeteve kryesore dhe ndihmese te prodhimit, te makinerive, te te gjitha mineraleve, te lendes drusore, te lendeve te para dhe te perpunuara per procesin e prodhimit; tregtimin e pasurive te luajteshme e te paluajteshme shitblerjen e tokes, tregtimin e mallrave te gatshem e gjysem te gatshme; etj; tregtimin me pakice te naftes, gazit natyror dhe nenprodukteve te tyre; ushtrimi i aktivitetit te bar- bufe- restorant, dhe njesive te tjera te tregtimit te pijeve alkoolike dhe produkteve ushqimore te gatshme dhe gjysem te gatshme.

5. Ne fushen e Energjise shoqeria do te realizoj aktivitetin ne te gjitha burimet e mundshme te energjise (hidro, ure, qymyr, karburante, etj.) per prodhimin e energjise. Ndertimin dhe operimin e hidrocentraleve, TEC-eve, stacioneve elektrike, nen-stacioneve elektrike, linjave te transmetimit te energjise, dhe strukturave te tjera ndihmese; Ndertimin, instalimin dhe perdorimin e njesive te prodhimit te energjise elektrike, dhe prodhimin, tamsmetimin dhe shperndarjen e energjise elektrike. Furnizimin dhe tregtine e energjise elektrike te cdo forme, eksportin e energjise elektrike jashte territorit te Republikes se Shqiperise (lidhja nderkombetare), dhe importin e energjise elektrike brenda territorit te Republikes se Shqiperise;

6. Ne fushen e transportit, shoqeria do te realizoj: Studimin, projektimin, konsulencen, sipermarrjen zbatuese dhe/ose investimin, sipas rastit, per realizimin me fonde publike dhe/ose jopublike te infrastruktures dhe/ose te pjeseve perberese te saj, per transportimin publik dhe/ose privat te njerezve dhe mallrave brenda dhe jashte territorit te vendit si dhe tranzitimin e tyre pergjate territorit te Shqiperise nepermjet transportit rrugor, hekurudhor, ajror, ujor, teleferik etj.

7. Ne fushen e turizmit shoqeria do te realizoj: Studimin, projektimin, konsulencen, sipermarrjen zbatuese dhe/ose investimin, sipas rastit, per realizimin me fonde publike dhe/ose jopublike te infrastruktures dhe/ose te pjeseve perberese te saj, per shfrytezimin njerezor me karakter pushues, argetues, edukues dhe/ose kurues, te burimeve natyrore, kulturore, mjedisore kurative, te Shqiperise dhe me gjere, per realizimin e hoteleri, fshate-turistike, qendra turistike e te tjera dhe krijimin e faciliteteve dhe aksesoreve te nevojshem, si bar bufe- restorante, qendra estetike, palestra fitnesi, njesi te shitjeve te konfeksioneve dhe prodhimeve ushqimore e industrial e te tjera te kesaj natyre; Krijimin e agjencive turistike e te tjera.

Ne perputhje me legjislacionin shqiptar, me qellim arritjen e objektivave te mesiperme, shoqeria mund:

a) te perdore (per vete) te gjitha sherbimet dhe prodhimet brenda objektit te veprimtarise se saj, te ofruara dhe/ose prodhuara nga ajo vete apo te Tretet.

b) te kryeje cdo transakcion ne lidhje me pasurite e luajtshme apo ato te paluajtshme, si dhe cdo aktivitet tregtar, financiar, te vendose pengje dhe barre hipotekore; aktivitete keto te konsideruara si te dobishme apo te nevojshme per te arritur qellimet e shoqerise dhe qe nuk tejkalojne ne mase aktivitetet kryesore, te cituara me siper.

Shoqeria do te kryeje cdo lloj aktiviteti ne raport me objektin dhe per te favorizuar ate. Shoqeria zbaton te gjitha ligjet dhe aktet nenligjore te duhura. Ajo zbaton standartet me te larta te etikes.

Neni 4

Kohezgjatja e Shoqerise

Kohezgjatja e shoqerise do te jete paafat. Ajo mund shperbehet ne cdo kohe dhe per cfardo lloj shkakut.

Kapitali i Shoqerise

Neni 5

Kapitali fillestar i shoqerise private "SURVEY SOLUTION" sh.p.k do te jete 100 leke (nje qind leke). Kapitali perbehet 100% nga kuotat e ortakut te vetem.

Kapitali themeltar fillestar mund te shtohet ose te pakesohet (por jo nen vleren e kapitalit themeltar fillestar).

Drejtimi i Shoqerise

Neni 6

Shoqeria do te drejtohet nga administratori i saj. Ai eshte perfaqesuesi ligjor i Shoqerise ne marredhenie me te tretet dhe ka kompetenca te plota ne drejtimin e saj.

Neni 7

Te ardhurat neto te shoqerise i takojne ortakut te vetem .

Neni 8

Ortaku i vetem themelues ka te drejte te emeruje dhe administratore te tjere te vlerave materiale Ka te drejte te caktoje financiere, likuidator per problemet e shoqerise si dhe te pajtoje persona te tjere si ortake.

Neni 9

Konfliktet qe mund te lindin do te zgjidhen ne zbatim te legjislacionit Shqipetar ne Gjykatën e Rrethit Gjyqesor Tirane.

Neni 10

Shoqeria ka vulen e saj me madhesi te zakonshme, me tekstin rreth saj.

Neni 11

Shoqeria deklarohet e krijuar ne zbatim te plote te normave te statutit dhe ne perputhje me legjislacionin Shqipetar ne fuqi dhe vecanerisht te Ligjit Nr.9901 date 14.04.2008 “Per Krijimin e Shoqerive Tregtare”, si dhe duke zbatuar ligjet nderkombetare dhe te vendit si dhe rregullave qe zbatohen per biznesin qe kryen kjo shoqeri.

Neni 12

Akti i themelimit u perpilua ne 3 kopje, per t'ju shperndare organeve kompetente dhe nje kopje do te mbetet ne dokumentacionin baze te shoqerise “Survey Consulting” sh.p.k

Akti i themelimit nenshkruhet rregullisht nga ortakut i vetem.

Ortak i vetem themelues i shoqerise “SURVEY SOLUTION” sh.p.k., eshte Gerard Lleshi.



Sot me date 15/04/2023, ne Tirana, u draftua dhe u nenshkrua me vullnetin e plote dhe te lire te Ortakut te Vetem, Akt Themelimit te "SURVEY SOLUTION" shpk, ne 3 kopje, ne gjuhen Shqipe, dhe me te njejten vlere ligjore.

Gerard Lleshi

A handwritten signature in blue ink, consisting of a large, stylized initial 'G' followed by a horizontal line and a small flourish.